



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1067/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Burim Ademi kryesues, Zyhdi Haziri dhe Kymete Kicaj anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga votuesi Valon Selimi nga Prishtina, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.1067/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur votuesi Valon Selimi nga Prishtina me të cilën ka kërkuar rinumërimin e votave në vendvotimin 1915E/05R në Prishtinë.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga votuesi Valon Selimi nga Prishtina me të cilën ka kërkuar rinumërimin e votave në vendvotimin 1915E/05R në Prishtinë, ku deklaroi se në atë vendvotim i njëjti e ka votuar kandidatin me nr. 26 nga radhët e Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, ndërsa të njëjti i janë publikuar 0 vota në rezultatet përfundimtare të shpallura nga KQZ-ja.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton votuesi Valon Selimi nga Prishtina ka paraqitur apel me të cilën ka kërkuar rinumërimin e votave në vendvotimin 1915E/05R në Prishtinë.

Apeli i ankuesit të lartpërmendur u refuzua përkitazi me kërkesën për rinumërim në VV-në e përmendur të dispozitivit të vendimit, pasi që sipas evidencës zyrtare të KQZ-së të gjitha fletëvotimet në këtë VV, për të gjithë kandidatët janë rinumëruar dhe nuk mund të rinumërohen edhe një here.

Gjithashtu paneli me rasti e vendosjes mori për edhe bazë pretendimet e ankuesit se i njëjti ka votuar në vendvotimin e apeluar, për panelin është e qartë se në këtë VV kandidati në fjalë ka pas vota dhe të njëjtat vota janë publikuar me rastin e publikimit të rezultatit përfundimtar, por me asnjë provë shkresore ankuesi në Vendvotimin e vendosur në dispozitiv nuk ka arritur ta argumentoj se ka parregullsi me rastin e publikimit të rezultatit apo ka me shumë vota sesa janë publikuar në rezultatit përfundimtar, prandaj u vendos si në dispozitivi të këtij vendimi.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me shkeljet e supozuara, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mund të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë vetëm theksime te pretenduara ne apel, gjë që pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.1067/2021 më datën 07.11.2021



Kryesues i Panelit
Burim Ademi

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.